



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 087/1 prot.

Elbasan, më 1. 7. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.55 dt.24.06.2025 “Për miratimin e planit të mbarështimit Ekonomia Pyjore Kuturman”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir **BEJTJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 697

Dt. 27.6.2025



VENDIM

Datë.26.06.2025

Nr. 4459 prot

Nr.55dt.24.06.2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT
EKONOMIA PYJORE “KUTURMAN”**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Bazuar në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.04.05.2020 i ndryshuar “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, Kreu III ,neni 11 “Mbarështimi i pyjeve”, pika 2b (Plane të mbarështimit të ekonomive pyjore, si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare. Planet e mbarështimit hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përgjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës), VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 24.06.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e Mbarështimit të ekonomisë pyjore “Kuturman” për periudhën 10 vjeçare 2025-2035
2. Ndjekia e objektivave dhe zbatimi i masave të parashtruara në planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore “Kuturman” do të ndiqen nga Struktura Përgjegjëse për Pyjet dhe Kullotat të Bashkisë Librazhd.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BICAKU

